

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË BORDIT INDUSTRIAL (BI)

Takimi i tretë i Bordit Industrial të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike/
Private Sector Partnerships to Strengthen Higher Education

Data:

19.12.2023

Fillimi:

10:00

Përfundimi:

11:40

Lokacioni:

Universiteti i Prizrenit, Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, Salla e Amfiteatrit

Pjesëmarrësit:

1. Ziriye Hasani, Dekane e FShK
2. Arbnore Shehu, Sekretare e FShK
3. Enis Qafëleshi, Makerspace – Kryetar i BI
4. Lulzim Guhelli, Ex-Cite
5. Visar Haxhifazliu, ITP Prizren
6. Fatos Dida, Proton Cable
7. Alper Yildirim, Telcomm
8. Valon Ibrahim, student në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike
9. Nehat Gashi, Koordinator i Qendrës së Karrierës dhe Alumni
10. Denur Paçaku, Asistent i Programit
11. Ariel Shaban, Specialist i Marrëdhënieve me Industrinë
12. Ardi Mejzini, Menaxher i Komunikimit
13. Arta Rrustemi, Menaxher e Financave dhe Operacioneve
14. Gentë Kadriu, Specialiste e Agrobiznesit
15. Getoar Krasniqi, Specialist i ICT

PËRSHKRIMI I TEMAVE TË TRAJTUARA DHE KONKLuzionET

I) Diskutim në BI

- **Ziriye Hasani:** Jemi në proces të hartimit të programit (lëndëve) të programit të studimit “Software Design”. Janë shtuar disa lëndë të reja pas komunikimit të fundit të cilin e kemi pasur. Ideja është që mentorët t’i udhëheqin disa nga lëndët [*Ziriye Hasani vazhdon me prezantimin e programit të studimeve, lëndëve, karakteristikave dhe mënyrave se si parashihet të zhvillohet ai*]. Në këtë program, punimi i diplomës nga studentët do të jetë një projekt, pra një produkt, një software ose ndonjë pjesë hardverike, varësisht njohurive dhe mundësive. Janë diskutuar brenda stafit akademik lëndët dhe ato janë ndarë për profesorët përkatës, gjithashtu janë marrë inpute edhe nga bizneset.
- **Lulzim Guhelli:** Do të ishte mirë që brenda lëndëve të kishte edhe lëndë të cilët kanë të bëjnë me menaxhimin e projekteve.
- **Getoar Krasniqi:** Duhet të jetë një mënyrë për ta menaxhuar punën. Duhet të ketë metoda, ku profesori vetë duhet ta ketë një metodë të menaxhimit të punës.
- **Lulzim Guhelli:** Studentët duhet të jenë të përgatitur prej tani për treg. Duhet të jenë të përgatitur për treg dhe t’i kenë të gjitha informatat e marra prej fakultetit. Ne si kompani e japim atë trajnim që është dy-ditor dhe është dinamik. Në bazë të eksperiencës deri tani me studentët dhe sektorin privat, ata kanë nevojë për këto. Ata bëjnë punë por kur e njohin framework-un i hapin më shumë njohuritë. Unë mbaj trajnime në universitete edhe në Prizren edhe në Prishtinë dhe e kam parë se kjo është nevojshme. Ne mbajmë trajnime ushtrime dhe për stafin akademik në universitete.
- **Getoar Krasniqi:** Do të ishte shumë mirë nëse trajnimet për profesorë do të mbaheshin përmes Qendrës për Përsosmëri në Mësimdhënie, prat të futet si modul dhe të ofrohet për profesorët.

- **Lulzim Guhelli:** Për mua nuk është problem, mund ta mbajmë atë për profesorët në universitet.
- **Zirije Hasani:** Sipas këtij programi, për të kaluar nga viti i parë në vitin e dytë duhet të ketë një muaj punë praktike, pastaj njëjtë prej vitit të dytë në vitin e tretë, duhet të ketë patjetër punë praktike dhe është si kusht për t'u regjistruar në vitin e radhës. Me këtë rast, punë praktike do të ketë edhe me përfundimin e studimeve, përkatësisht në semestrin e fundit.
- **Visar Haxhifazliu:** Do të flas me m
- enaxhmentin sepse besoj se mund të ndihmojmë.
- **Valon Ibrahim:** Ka më shumë lëndë dhe besoj se do të jetë program i mirë.
- **Alper Yildirim:** Mendoj se lënda e matematikës duhet të ketë më shumë kredi në vlerësim, meqë lënda e matematikës ndërlihet me lëndët tjera apo thënë më mirë është bazë për njohjen e lëndëve të tjera.
- **Zirije Hasani:** Do të shohim për këtë ide dhe mundësitë që të përfshihet më shumë lënda e matematikës në programin e studimeve.
- **Lulzim Guhelli:** Do të ishte mirë që edhe një nga lëndët zgjedhore që janë aty të lidhet me matematikën.
- **Enis Qafëleshi:** Ky program i studimeve nuk është program shkencor i shkencave kompjuterike apo inxhinieri. Është program për studime specifike bachelor. Ky program është shumë i moderuar dhe mund t'iu përshtatet kompanive të zhvillimit të software. Kërkesa për momentin është e nivelit të lartë dhe industria po kërkon profil të tillë.
- **Getoar Krasniqi:** Ndoshta studimet master do të mund të ishin me më shumë lëndë të matematikës.
- **Enis Qafëleshi:** Dua ta falënderoj projektin që po ndihmon në funksionalizimin e Bordit Industrial. Ne si bord nuk po mund t'i shohim fytyrat apo njerëzit të cilët kemi nevojë t'i takojmë, ku një koment i secilit e bën të plotë nevojën e këtij takimi. Do të doja që nga sekretariati apo projekti të na përcjellin një plan për akreditimin e programeve. Na intereson se si ne si anëtarë do ta shfrytëzojmë një program të tillë në tregun tonë lokal e më gjerë. Universiteti i Prizrenit e ka pasur më herët këtë program, por tani shumë mirë që po kthehet përsëri pasi që është i nevojshëm. Ky mund të jetë një program ndryshe i përshtatshëm për të gjithë, por do të ketë një ndikim të rinjtë e këtij regjioni. Ne si bord duhet të reformohemi, pra ta ndryshojmë anëtarësinë. Ftesat të cilat dërgohen sot nga sekretariati apo projekti janë edhe te disa që më parë nuk kanë qenë asnjëherë prezentë dhe për këtë ne duhet ta reformojmë atë. Prezenca këtu dëshmon angazhimin e një anëtari. Neve na duhet një takim nëse me projektin ose pa projektin, për ta parë se si ne mund të ndikojmë aktivisht në zbatimin e kësaj kurrikule. Ky program të bëhet garues serioz në programet që ofrojnë universitetet tjera. Kjo mund të tingëllojë e vështirë apo e lehtë, mirëpo fakti që ka projekte si ky me Iowa-n, fakti që Universiteti i Prizrenit ka marrëveshje me entitete tjera, nënkupton se ka mbështetje. Është mirë që për vitin e ardhshëm ky bord ta ketë një plan veprimi. Do të ishte mirë të takohemi në javët e ardhshme të muajit tjetër për të biseduar për këto detaje. Nuk e di a do të ketë shumë kohë për diskutimin e kurrikulës [Zirije Hasani: sot], por duhet ta shohim se si mund ta ndihmojmë zhvillimin industrial të të rinjve. Neve si industri na mbetet se t'ia japim një ngjyrim më të mirë këtij programi të studimeve. Edhe mua më interesojnë disa pjesë si menaxhimi, nxitja e ndërmarrësisë, por është një program i moderuar dhe për bachelor ky është shumë afër të jetë një program për arsim dual. Tash është koha që ta marrim edhe programin TIT dhe të shohim se çfarë mund të bëjmë me të.
- **Ariel Shaban:** Është i vetmi bord që gjatë diskutimit po kërkohet një plan veprimi. Është sfiduese për ne, por kjo të bëhet prej dekanes. Ne i kemi planet tona për vitin e ardhshëm që do t'i prezantojë Arta dhe do të parashohim bashkëdyzim në zhvillimin e aktiviteteve dhe do të jemi shumë më të organizuar për të dhënë informata më herët, për të përgatitur diskutime ende më domethënëse. Ne në pesë borde të tjera nuk e kemi një pjesëmarrje të kënaqshme të Bordit Industrial. Mbetet që me Enis Qafëleshin dhe dekanatin të shihet se çfarë do të ndodhë me listën e pjesëmarrësve në bord. Sipas rregullores nëse nuk vijmë dy herë, atëherë edhe mund të largohen nga bordi.

Ne kemi dashur që t'i mbledhim këto takime për t'i informuar pjesëmarrësit për takimet në Training of Trainers (ToT) dhe Corporate Panels (CP) dhe me këtë rast në Universitetin e Prizrenit jemi fokusuar në programin e agrobiznesit. [Arieli ua prezanton pjesëmarrësve disa nga detajet e organizimit/ mbajtjes së ToT dhe CP]. Kemi kërkuar përgjigje nga përfaqësuesit e kompanive për atë se çfarë është e rëndësishme për ta në temat që ne i kemi diskutuar dhe më pas i kemi marrë ato të dhëna dhe i kemi vendosur në tabelat që po i prezantojmë. I kemi pyetur se cilat janë trendet ose çfarë presin ata në tre vitet e ardhshme. Ka pasur pak a shumë kërkesa të njëjta mes FIEK-ut dhe FShK-së. Çfarë kemi parë si tema të rëndësishme të enidentuara apo si çështje janë: AI; Siguria Kibernetike; Deveops; Etika në TI; Shkenca e të Dhënave etj. [Arieli Shaban prezanton rezultatet dhe rekomandimet kryesore të Paneleve Korporative].

- **Zirije Hasani:** Kemi parë më herët mundësi për krijimin e programeve studimore që ndërlidhin bujqësinë me teknologjinë mirëpo ishte e vështirë meqë edhe aktualisht nuk kemi staf akademik për atë pjesë. Është përmendur në FIEK që ka pasur nevojë për inkuadrimin e soft skills si lëndë në programin e studimeve, mirëpo kjo gjë nuk preferoj të jetë. Në planet e veprimit të bordeve mund të ketë takime ku grupi studentëve mund të marrë pjesë në takime, nga ku sektori privat mund të marr komente prej studentëve, por ata edhe mund t'i prezantojnë projektet e tyre siç është paraparë në programin e studimit, në mbledhjet e Bordeve Industriale. Me këtë rast ata mund të marrin komente nga kompanitë pjesëmarrëse.
- **Ariel Shaban:** Ne në vazhdimësi i zgjedhim programet studimore që kanë nevojë të trajtohen. Në vijim po ia jap fjalën Getoarit për të prezatuar. [Getoari prezanton].
- **Zirije Hasani:** Tema e diplomës të mos jetë tezë klasike, por të integrohet edhe si punë praktike.
- **Zirije Hasani:** Puna në grup është problem shkaku i natyrës së punës së një punëtori të fushës së shkencave kompjuterike, shpesh studentët kanë problem në aftësitë për prezantim.
- **Lulzim Guhelli:** Kur flitet për lirimimin e studentëve/ softskills dhe interaktivitetit, mësimdhënësit kanë rëndësi në këtë pjesë.
- **Arta Rrustemi:** Në janar pritet ta kemi të aprovuar planin e vitit të dytë të projektit i cili duhet të aprovet nga USAID dhe nuk mund ta prezantojmë pa pasur aprovim. Si koment në planin për vitin 2024, parashihet që takimet të jenë çdo tre muaj, do të jetë ToT, do të jenë 4 programe të studimeve. Detyra juaj si bord është të na ndihmoni në Panelet Korporative të cilat mbahen në shtator apo tetor. Do të doja që edhe ju të na i rekomandoni personat nga kompanitë. Persona si ju duhet të jenë në Panelet Korporative. Ne po raportojmë, kemi raportuar, linqet janë të gatshme për t'i gjetur materialet që përdoren gjatë mbledhjeve të bordit.

AKTIVITETE TË PLANIFIKUARA (NËSE KA)

AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	AFATI I FUNDIT
N/A	N/A	N/A

Procesverbali është hartuar nga: Denur Paçaku

Denur Paçaku

Pogram Assistant,
Private Sector Partnerships to Strengthen Higher Education,
USAID Grantee,
Iowa Consortium, University of Iowa,
Prizren, Kosovo, 20 000 (GMT +2),
Mobile: +383 48 265 012.

IOWA